

URDHËR I PËRBASHKËT
Nr. 808, datë.31.12.2019

**PËR MIRATIMIN E PLANIT TË MASAVE, NË ZBATIM TË PROGRAMIT TË
DALJES NGA SKEMA E NDIHMËS EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 2, të nenit 19, të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” dhe të pikës 24, të vendimit nr. 882, datë 24.12.2019, të Këshillit të Ministrave “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”,

URDHËROJMË:

1. Miratimin e planit të masave në zbatim të programit të daljes nga skema e ndihmës ekonomike, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri.
 2. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në planin e masave dhe institucionet në varësi të tyre, për zbatimin e aktiviteteve të këtij plani, sipas fushës së përgjegjësisë shtetërore.
 3. Ngarkohen për ndjekjen e zbatimit të këtij urdhri struktura përgjegjëse për ndihmën ekonomike në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe struktura përgjegjëse për punësimin dhe formimin profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
- Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

**MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu**

**MINISTËR I FINANCAVE
DHE EKONOMISË
Anila Denaj**

PLANI I MASAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË DALJES NGA SKEMA E NE 2020 – 2022

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^c	Burimet financimit ^e
1	Saktësimi i të dhënave për punëkërkesit e papunë, përfitues të NE	1.1	Ndryshime në Raportimin Statistikor për NE duhet të përfshijnë: 1) informacion të saktë lidhur me problemet sociale me të cilat përballet aplikanti të cilat përbëjnë pengesë për përfshirjen e tyre sociale dhe produktive; 2) profesioni i aplikantit, eksperiencia e punës dhe trajnimet që ka përfituar gjatë jetës së tij	Moduli i NE i modifikuar	MSHMS SHSSH	TM 1 2020	2,393,125.0	Buxheti Shtetit Donatorët
		1.2	Saktësimi i të dhënave për punëkërkesit e papunë, përfitues të NE, profili i tyre në përputhje me: 1) vendodhjen gjeografike, 2) grup-moshën, 3) gjininë, 4) përbërjen familjare, 4) edukimin, 5) profesionin, 6) eksperiencën e punës, 7) trajnimet e ndjekura, 8) koha e qëndrimit në skemën e NE, 9) masa e NE nga e cila ata përfitojnë, etj. Sigurimi i aksesit në kohë reale nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkitë	Bazë të dhënash e sakta dhe e përditësuar e përfituesve të punësueshëm të NE.	MSHMS SHSSH	TM 1 2021	2,008,125.0	Buxheti Shtetit
		1.3	Shërbimi Social Shtetëror dhe Bashkitë përgatisin listën vjetore të Përfituesve të NE që pritet të dalin nga skema e NE në dy vitet e ardhshme. Kjo listë vihet në dispozicion të Ministrive	Lista e përfituesve të NE që pritet të dalin nga skema	SHSSH Bashkitë	në vazhdim	11,543,000.0	Buxheti Shtetit

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
			përgjegjëse për mbrojtjen sociale dhe promovimin e punësimit.					
		1.4	Shkëmbimi i informacionit mes SHSSH dhe SHKP për Planet Sociale në nivel Bashkie	SHSSH grumbullon planet sociale të Bashkive dhe i dërgon pranë SHKP	SHSSH SHKP Bashkitë	Çdo 3 vjet	2,700,000.0	Buxheti i Shtetit
		1.5	Përmirësimi dhe mirëmbajtja e regjistrit elektronik të NE për të siguruar përgatitjen dhe integrimin në regjistrin elektronik të modulit të Planit të Veprimit Individual të integruar dhe dhe integrimin në kohë reale të Planit Social individual dhe Planit të Punësimit individual për përfituesit e NE që do të dalin nga skema e NE	Një bazë të dhënash të saktë dhe të azhurnuar të përfituesve të punësueshëm të NE dhe stafit të trajnuar më mirë	MSHMS MFE	në vazhdim	46,409,661.0	Buxheti Shtetit
		1.6	Kualifikimi i vazhdueshëm i stafit, në të gjitha nivelet për përdorimin e regjistrit kombëtar dhe për kryerjen e përgatitjes së Planeve Sociale individuale dhe Planeve të Punësimit individual	Staf i trajnuar	MSHMS MFE	në vazhdim	178,500.0	Buxheti Shtetit
2	Përgatitja e kuadrit ligjor për zbatimin e programit të daljes nga NE	2.1	Miratimi i Programit të Daljes nga NE nga Këshilli i Ministrave dhe publikimi i tij në Fletoren Zyrtare si dhe në faqen zyrtare të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Programi i Daljes nga NE i miratuar	MSHMS	TM4 2019	286,363.6	Buxheti Shtetit

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
		2.2	Përgatitja dhe ndryshimi i Vendimit të Këshillit të Ministrave “Për Mekanizmat e Bashkëpunimit Ndërinstitucional për rastet e punësimit të individëve të punësueshëm dhe antarëve të familjes që janë përfitues nga NE”	VKM e ndryshuar	MSHMS	TM1 2020	817,727.3	Buxheti Shtetit
		2.2.1	Trajnimi i stafit të SHSSH, i Agjencisë Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive, strukturave të shërbimeve sociale dhe zyrave të punësimit në nivel lokal në lidhje me Mekanizmin e Bashkëpunimit Ndërinstitucional për rastet e punësimit të individëve të punësueshëm dhe antarëve të familjes që janë përfitues nga NE”	Stafi trajnuar	MSHMS	TM1 2020	2,574,090.9	Buxheti Shtetit
		2.3	Përgatitja e Dokumentit Indikativ Vjetor për integrimin e Përfituesve të NE në tregun e punës	Dokumentit Indikativ Vjetor	MSHMS	TM1 çdo vit	1,880,454.5	Buxheti Shtetit
		2.4	Rishikimi i Nenit 19, pikat 2 dhe 3 të Ligjit 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” për përfshirjen e përfituesve të NE të regjistruar si punëkërkues të papunë.	VKM e ndryshuar	MFE	TM1 2020	1,921,818.2	Buxheti Shtetit
		2.5	Propozimi i ndryshimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave (VKM), për të amenduar VKM Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për aprovimin e rregullave për Prokurimin	Propozimi i dërguar pranë Agjencisë së Prokurimit Publik	MSHMS MFE	TM1 2020	2,208,181.8	Buxheti Shtetit

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
			Publik” Nenet 26 “Kontratat për Punët Publike” dhe 28 “Kontratat për Shërbimet”					
		2.6	Përgatitja e kuadrit nënligjor në zbatim të ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”	xxx VKM të miratuara	MFE	TM3 2020	30,265,454.50	Buxheti Shtetit
		2.8	Draftimi dhe miratimi i një udhëzuesi (protokoll pune) për të përcaktuar rolin dhe përgjegjësitë e aktorëve të përfshirë, koordinimin dhe bashkëpunimin si dhe shkëmbimin e të dhënave për përgatitjen e Planeve Individuale nga institucionet respektive përgjegjëse	Udhëzuesi i hartuar dhe miratuar	MSHMS MFE	TM3 2020	16,579,931.8	Buxheti Shtetit Donatorët
		2.8.1	Informimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit të SHSSH dhe stafit të Bashkive për përgatitjen e Planit Individual Social për përfituesit e NE të cilët do të dalin nga skema e NE rreth koordinimit me Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive		MSHMS SHSSH	TM1 2021		
		2.8.2	Informimi dhe ngritja e kapaciteteve të stafit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive për përgatitjen e Planit Individual të Punësimit për përfituesit e NE të cilët do të dalin nga skema e NE rreth koordinimit me		MSHMS MFE AKPA	TM1-2 2021		

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjës	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
			Shërbimin Social Shtetëror dhe bashkitë					
		2.9	Tryeza të rrumbullakta në nivel kombëtar dhe lokal për të prezantuar ndryshimet legjislative dhe programin e daljes nga skema e NE		MSHMS MFE	TM2 2021	571,750.0	Buxheti Shtetit
		2.10	Tryezë e rrumbullakët me Dhomat e Tregtisë dhe Shoqatat e Biznesit për të prezantuar programin e daljes nga skema e NE dhe ndryshimet legjislative		MSHMS MFE	TM1 2021	386,750.0	Buxheti Shtetit
3	Monitorimi dhe implementimi i programit të daljes nga skema NE	3.1	Grumbullimi i të dhënave lidhur me implementimin dhe dinamikat e Programit të Daljes nga skema NE në lidhje me rastet, trajnimet dhe punësimin e individëve në dalje nga skema e NE	Informacioni i organizuar statistikor, i përdorur në formulimet e politikave	MSHMS MFE	TM1 2021	3,927,000.0	Buxheti Shtetit
		3.2	Analiza e të dhënave të përfituesve të NE-së që janë në moshë aktive bazuar në profilin e tyre social dhe nevojat sociale.	Raporte periodike	SHSSH	TM 4 2020-2022	6,480,000.0	Buxheti i Shtetit
		3.3	Përgatitja e raporteve me bazë tre-mujore për të treguar progresin dhe çështjet e hasura gjatë implementimit dhe dinamikat e Programit të Daljes nga skema NE në lidhje me rastet, trajnimet dhe punësimin	Raportet tre-mujore të dorëzuara tek Ministri përgjegjës për çështjet sociale dhe Ministri përgjegjës për punësimin	Ekipet e punës të ngritura në nivel rajonal e vendor si pjesë e mekanizmit	në vazhdim (çdo tre muaj)	3,108,000.0	Buxheti Shtetit

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni pergjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
			e individeve në dalje nga skema e NE.		bashkërendues Grupi Teknik Ndërmnistro r GTN			
		3.4	Përcaktimi i strukturave të monitorimit, vlerësimit dhe raportimit në lidhje me implementimin e programit të daljes nga skema NE; punësim i stafit nëse është e nevojshme	Strukturat e monitorimit të krijuara	MSHMS	TM 4 2021	3,960,000.0	Buxheti Shtetit
		3.5	Trajnimi i vazhdueshëm i ekspertëve të strukturave të Monitorimit dhe Vlerësimit në lidhje me implementimin e Programit të Daljes nga skema e NE	Trajnimi I strukturave i realizuar	MSHMS MFE SHSSH AKPA	në vazhdim	118,125.0	Buxheti Shtetit
		3.6	Draftimi i mekanizmit të ankimimit të përfituesve të cilët dalin nga skema e NE dhe rishikimi i kriterëve përjashtimorë nga rregulli i përfundimit të afatit si dhe kushtet dhe kriteret për ri-aplikimin në programin e NE	Udhëzimi për Mekanizmin e Apëlimit të përfituesve i hartuar Përcaktimi i kriterëve të reja përjashtimorë nga rregulli i përfundimit të afatit si dhe kushtet dhe kriteret për ri-aplikimin në programin e NE	MSHMS		13,860,000.0	Buxheti Shtetit

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
4	Vlerësimi i impaktit të masave në daljen nga skema e NE dhe punësimin e qëndrueshëm të përfituesve të mëparshëm të NE.	4.1	Hartimi i Raportit për Vlerësimin Sasior dhe Cilësor të zbatimit dhe efektivitetit të masave të PATP-ve në integrimin dhe ri-integrimin e suksesshëm të përfituesve të NE në tregun e punës	Raport vlerësimi i ndikimit të zbatimit të masave të PATP-ve I hartuar dhe diskutuar	MFE	TM4 2021-2022	3,167,500.0	Buxheti Shtetit Donatorët
5	Konsultimi dhe Ndërgjegjësimi i publikut lidhur me Programin e Daljes nga skema e NE nëpërmjet fushatave të ndërgjegjësimit dhe informimit të vazhdueshëm të publikut mbi zbatimin e tij	5.1	Përgatitja e artikujve me destinacion portalet/gazetat të cilat të shpjegojnë Programin e Daljes, masat që ajo përfshin për një tranzicion të butë nga NE, tek trajnimet dhe punësimi i përfituesve të NE dhe familjeve të tyre, që të shpjegojnë gjithashtu avantazhet e nje aksioni të tillë, të ilustruara me histori suksesi – duke pasqyruar histori të përfituesve të ngjashëm nga i njejtë rajon.	12 artikuj Viti I 6 artikuj në vitet në vazhdim	MSHMS MFE	TM 4 2022	2,191,818.2	Buxheti Shtetit Donatorët
		5.2	Takime në bashki me personat e interesuar, familjet e përfituesve të NE, me zyrtarë të shërbimit social shtetëror dhe të agjencive të punësimit, OJQ të cilat zbatojnë projekte me financime të huaja në rajon, pronarë të bizneseve lokale, me diskutime rreth trajnimeve, edukimit dhe mundësive të punësimit në punët publike dhe jo vetëm. Takimet do të kenë edhe	61 takime	MSHMS MFE	TM4 2020	129,818.2	Buxheti Shtetit

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
			prezencën e mediave lokale.					
		5.3	Përgatitja e njoftimeve për shtyp, me informacione të detajuara rreth strategjisë, avantazheve që masat e tranzicionit do t'i sjellin përfituesve të NE pasi të kenë hyrë në tregun e punës, rreth historive të suksesit që ilustrojnë punësueshmërinë e përfituesve të NE, etj.	1 artikull në çdo tre muaj	MSHMS MFE	në vazhdim	246,330.0	Buxheti Shtetit Donatorët
		5.4	Raportime në TV (jo me shumë se 3-4 minuta), me intervista dhe mesazhe kyçe nga personat e interesuar, me persona të cilët janë larguar tashmë nga skema e NE dhe janë punësuar si dhe me zyrtarë lokale. Debate në studio në TV kombëtare dhe lokale në lidhje me rëndësinë e strategjisë së Daljes nga NE	6 seri TV do të përgatiten gjatë vitit të parë në TV kombëtare dhe lokale 3 programe speciale Në TV për t'u transmetuar në mediat kombëtare 12 debate në studio në TV lokale	MSHMS MFE	TM4 2020	2,598,315.0	Buxheti Shtetit Donatorët
		5.5	Broshurë elektronike e cila të shpjegojë në mënyrë të thjeshtëzuar të gjithë konceptin	1 broshurë elektronike e prodhuar dhe shpërndare	MSHMS MFE	TM4 2020	752,850.0	Buxheti Shtetit Donatorët

Masat		Aktivitetet		Produkti	Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
			e strategjisë, hapat që duhen ndërmarrë nga përfituesit, avantazhet e realizimit të këtyre hapave drejt një tranzicioni nga NE, tek punësimi i pjesshëm apo i plotë.					
		5.6	Boshura/fletëpalosje të printuara të cilat shpjegojnë në mënyrë të thjeshtëzuar të gjithë konceptin e strategjisë, hapat që duhen ndërmarrë nga përfituesit, avantazhet e realizimit të këtyre hapave drejt një tranzicioni nga NE, tek punësimi i pjesshëm apo i plotë.	2000 kopje broshurash 30,000 fletëpalosje	MSHMS MFE	TM4 2020	4,378,501.9	Buxheti Shtetit Donatorët
		5.7	Seksioni i dedikuar në faqen zyrtare të Ministrisë, Shërbimit Social Shtetëror, me informacione të detajuara në lidhje me strategjinë, mënyrën se si do të implementohet ajo, aktivitetet që do të organizohen në çdo rajon për të informuar personat e interesuar, formatet elektronike të broshurave dhe fletëpalosjeve informuese, ashtu si edhe video me përmbajtje shpjeguese.	seksion në faqen zyrtare	MSHMS MFE	TM2 2020	214,200.0	Buxheti Shtetit
		5.8	Postime periodike në rrjetet dhe mediat sociale të Ministrisë dhe Shërbimeve Sociale Shtetërore në lidhje me të gjitha aktivitetet e sipër-përmendura, si edhe rrethe përmbajtjes që do të përgatitet gjatë implementimit të tyre.	4 postime në muaj	MSHMS MFE	në vazhdim	584,181.8	Buxheti Shtetit

Masat		Aktivitetet		Produkti		Institucioni përgjegjes	Mbarimi	Kostoja zbatimit (leke) ^e	Burimet financimit ^e
		5.9	Anketime periodike të kryera nga zyrtare të informimit dhe marrëdhënieve me Publikun (PR), me qëllim matjen e nivelit të informimit të përfituesve të NE dhe personave të interesuar.	çdo 6 muaj		MSHMS MFE	në vazhdim	1,285,200.0	Buxheti Shtetit
	TOTALI						169,726,773.70		